

MARRËVESHJE PËR ZGJIDHJE KONTRATE

Lidhur sot në Tiranë, më datën 21/07/2022 (Dymijë e njezet e dy) mes palëve si vijon:

Pala e parë:

Z. Naimir Kurti, me banim në Tiranë, Rruga Reshit Collaku, i datelindjes 06/03/1976 lindur ne Grabian të Lushnjes, i pajisur me karten e identitetit me numer H60306059V;

Pala e dytë:

Z. Enkelev Kurti, me banim në Rr. Alqi Boshnjaku, i datelindjes 26/09/1966 lindur ne Lushnje dhe banues ne Tirane, i pajisur me karten e identitetit me numër G60926092G.

Palët, në vijim të negociatave mes tyre vendosën të lidhin këtë marrëveshje për zgjidhje kontrate si vijon:

Konsiderata Paraprake:

1- Palët Naimir Kurti dhe Enkelev Kurti kanë lidhur kontratën e shitblerjes së kuotave datë 17.02.2022 me anë të së cilës pala e parë Naimir Kurti i ka shitur Palës së Dytë Enkelev Kurti kuotën që zotëronte në shoqërinë “Wondervolt 2018” shpk (NUIS L81423001S).

2- Kjo kontratë datë 17.02.2022 është dërguar për regjistrim pranë QKB dhe është regjistruar rregullisht. Për pasojë, Pala e Dytë Enkelev Kurti është ortaku i vetëm i shoqërisë “Wondervolt 2018” shpk (NUIS L81423001S) duke zotëruar një kuotë të barabartë me 100% (njëqind) të kapitalit themeltar të kësaj shoqërie.

3- Megjithatë, rezulton se blerësi për arsye financiare parashikon se nuk do të jetë në gjendje të paguaj çmimin e blerjes brenda afateve të dakordësuara në kontratë dhe për pasojë dëshiron që të zgjidhë kontratën e sipër përmendur datë 17.02.2022 pa penalitete duke u rikthyer palët në gjendjen e mëparshme.

Për sa më sipër lidhet kjo marrëveshje për zgjidhje kontrate dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.

Neni 1 – Objekti i kontratës:

Nëpërmjet kësaj kontrate Pala e Parë Naimir Kurti dhe Pala e Dytë Enkelev Kurti bien dakord që të zgjidhin kontratën datë 17.02.2022 si dhe të rregullojnë pasojat e kësaj zgjidhjeje.

Në zbatim të kësaj marrëveshjeje e gjithë kuota që zotërohet nga Pala e Dytë Enkelev Kurti në shoqërinë “Wondervolt 2018” shpk (NUIS L81423001S) që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të kësaj shoqërie që është përfutur prej tij në zbatim të kontratës datë 17.02.2022 të sipër përmendur do t’i kthehet Palës së Parë Naimir Kurti sipas parimit “siç është aty ku është”.

Neni 2 – Rregullimi i pasojave:

Palët bien dakord që nuk do t’i kërkojnë njëra tjetrës asnjë dëmshpërblim dhe heqin dorë nga çdo padi apo pretendim të bazuar në kontratën datë 17.02.2022.

Palët dakordësohen që pronësia e kuotave që përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë “Wondervolt 2018” shpk (NUIS L81423001S) që është përfutur në zbatim të kontratës datë 17.02.2022 të sipër përmendur do t’i kthehet Palës së Parë Naimir Kurti në datën e lidhjes së kësaj marrëveshjeje dhe sipas parimit “siç është aty ku është”.

Zgjidhja e kontratës datë 17.02.2022 dhe kthimi i pronësisë së kuotës nuk do të ketë efekt prapaveprues. Për pasojë, të gjitha veprimet e kryera nga Pala e Dytë Enkelev Kurti që janë në përputhje me ligjin do të konsiderohen të mirëqena dhe të vlefshme nga Pala e Parë.

Neni 3 – Kalimi i pronësisë mbi kuotën:

Pronësia mbi kuotën kalohet që në momentin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje për zgjidhje kontrate.

Neni 4 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për çdo mosmarrëveshje palët do t’i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

U bë në 3 (tre) kopje, një për secilën palë dhe një kopje depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nga palët ose administratori i shoqërisë.

Pala e parë

Naimir Kurti

Naimir Kurti



Pala e Dytë

Enkelev Kurti

Enkelev Kurti
